

Përkufizimet

Ju – në këtë dokument ju kemi drejtuar juve si person, klientëve ekzistues, të mëparshëm dhe të ardhshëm;

Ne - IMF AFK Agjencioni për Financim në Kosovë, me seli qendrore në rr. Lidhja e Prizrenit Nr. 1, Pejë;

Hyrje

Agjencioni për Financim në Kosovë gjatë ushtrimit të veprimtarisë kreditore mikrofinanciare dhe bashkëpunimit me klientët e saj, apo palët e treta, mbledh, përpunon, kontrollon, ruan të dhëna personale të subjekteve më të cilët bashkëpunon. AFK është e përkushtuar në mbrojtjen e të dhënave personale dhe respektimin e privatësisë, sa që, për këtë ka aprovuar politikën e brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe ka ndërmarrur masa teknike dhe organizative për arritjen e këtij qëllimi.

Në kuadër të fushë veprimtarisë tonë, Ne jemi të angazhuar që të veprojmë në përputhje me ligjet e aplikueshme në Kosovë si dhe legjislacionin ndërkombëtar (GDPR) dhe politikat tona të brendshme. Ne bazohemi në parimet themelore të pranuar për mbrojtjen e të dhënave personale (parimi i ligjshmërisë, drejtësisë, transparencës, kufizimit të qëllimit, etj) duke vendosur themele të besueshme për mbrojtjen e privatësisë gjatë zhvillimit të aktiviteteve mikrofinanciare.

Qëllimi i dhënies së këtyre informacioneve është informimi i klientëve individual ekzistues, të mëparshëm dhe klientëve të ardhshëm për të dhënat personale që Ne i mbledhim, nga kush i mbledhim (subjekti i të dhënave), qëllimi i mbledhjes së këtyre të dhënave, më kë i ndajmë ato të dhëna personale, sa gjatë i mbajmë ato, cilat janë të drejtat e juaja si subjekt i të dhënave personale dhe si mund ti realizoni këto të drejta. Ne i mbledhim të dhënat personale nga Ju drejtpërdrejt pas dhënies së pëlqimit nga Ju, apo përmes burimeve të tjera si: përmes aplikimit tuaj përmes internetit, rrjeteve dhe komunikimeve elektronike, pasi që Ju plotësoni rubrikat e caktuara kur aplikoni për produkte kreditore tek Ne. Po ashtu, Ne mbledhim të dhënat tuaja personale përmes platformave me të dhëna të vëna në dispozicion nga autoritetet publike. Këtë e bëjmë gjatë procesit për verifikimin e informatave me rastin e shqyrtimit të mundësisë së lidhjes së kontratave për dhënien e shërbimeve kreditore, klientëve, për të cilat shërbime Ne jemi të licencuar nga BQK.

1. Në kuadër të aktiviteteve tona, Ne mbledhim përpunojmë dhe ruajmë këto të dhëna personale;

1.1 Të dhënat bazë: emri, mbiemri, numri personal, data e lindjes, numri identifikues i dokumentit, gjinia, dhe informacione që ndërlidhet me identifikimin tuaj direkt dhe indirekt.

1.2 Adresa, informatat e punësimit dhe familjare: vendbanimi apo vendqëndrimi, statusi i/e punësuar, të ardhurat personale, emri i punëdhënësit, kualifikimi dhe profesioni që ushtroni, nëse ju përfaqësoni apo jeni pronar të biznesit të caktuar apo pronar i aksioneve. Ne do të kërkojmë të dhëna dhe dokumentacionet me informata për marrëdhëniet banesore, Statusin martesor, numri i anëtarëve në familjen ku jetoni, punësimi i anëtarëve të familjes, nëse keni anëtar të familjes që punojnë jashtë vendit, etj, sipas qëllimit të produktit kreditor.

1.3 Informacioni kontaktues: gjatë periudhës së zbatimit të raporteve kontraktuale apo komunikimit të materialeve të marketingut për shërbimet tona, Ne mbledhim, përpunojmë, ruajmë këto të dhëna personale nga Ju: numri i telefonit, e-maili apo adresa elektronike, adresa për pranimin e dërgesave postare.

1.4 Historinë kreditore dhe financiare: Në përmbushjen e interesit tonë legjitim, Ne mbledhim dhe shpërndajmë informata në **Regjistri i Kredive i Kosovës (RKK)**, dhe jo vetëm, me qëllim kryerjen e procesit vlerësues, verifikues dhe raportues të obligimeve të klientëve gjatë analizimit për mbështetje dhe raportimit të produkte kreditore. Këto veprime tona realizohen në pajtim me ligjet dhe aktet nën ligjore të aplikueshme në vendit tonë.

1.5 Të dhëna financiare, dhe biznesore: pasqyra financiare, gjendje të xhirollogarisë bankare, libra të biznesit, dokumentacioni i regjistrimit të biznesit dhe dokumentacione të tjera të biznesit me qëllim të justifikuar për analizimin financiar gjatë dhënies së shërbimeve financiare.

1.6 Të dhëna të tjera: si të dhëna lidhur me shfrytëzimin e produkteve tona nga ju, të dhënat nga komunikimet tona me ju, me telefon apo përmes platformave elektronike, komunikimet me shkrim, me zë, intervista të dhëna nga ju për Ne, sipas pëlqimit tuaj personal të dhënë, apo informacione me të dhëna personale të tjera, të cilat direkt apo indirekt i kemi mbledhur nga Ju, në përputhje dhe brenda kufijve të qëllimit nga fushë veprimtaria mikrofinanciare.

Ne, në rrethana të caktuara mund të mbledhim informata rreth Juve, ani pse nuk kemi raporte të drejtpërdrejta me Ju. Kjo për arsye kur për Juve kemi mbledhur informata nga palë të treta të autorizuar, ose kur informata tuaja i kemi marrur nga bashkëpunëtorët tuaj në raste kur ju jeni: 1) Aksionar në një Shoqëri Tregtare; 2) Përfaqësues i autorizuar apo ligjor i personit juridik; 3) Apo rrethana të tjera të justifikuara dhe brenda qëllimit të kufizuar për dhënien e shërbimeve mikrofinanciare dhe pa e kapërcyer këtë qëllim.

2. Qëllimi i mbledhjes përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave personale

Ne jemi të licencuar nga BQK që të zhvillojmë veprimtari mikrofinanciare, dhe në përputhje me këtë, Ne mbledhim të dhënat personale tuaja me qëllim realizimit të një kontrate me klientin tonë potencial, ose që të ndërmarrim hapa për t'iu përgjigjur aplikimit të klientit potencial për marrjen e ndonjë produkti kreditor tonë. Gjatë kontraktimit me Ju, Ne do të kërkojmë dokument identifikues valid më qëllim identifikimin tuaj të saktë, respektivisht identifikimin e klientit tonë.

Tutje, mbledhja e të dhënave tuaja personale ndërlidhet me efikasitetin tonë në dhënien e shërbimeve, rrjedhimisht ofrimin e produkteve kreditore mikrofinanciare, andaj informatat që Ne i mbledhim nga Ju na ndihmojnë për një vendimmarrje të drejtë, brenda një kohe të saktë dhe sa më objektive, menaxhimin e duhur të rrezikut, përmirësimin e shërbimeve tona për produktet aktuale apo produktet financiare të reja.

Marrja e të dhënave tuaja na ndihmon në personalizimin e ofertës tonë për Ju, duke identifikuar produktin kreditor tonin që Juve më së shumti u përshtatet, si dhe mbajtja e kontaktit me Ju me qëllim që juve t'iu mbajmë të informuar me ofertat promovionale të produkteve tona.

3. Baza ligjore / arsyeja e ruajtjes / periudha e ruajtjes dhe siguria

Realizimi i interesit tonë legjitim nga fushë veprimtaria mikrofinanciare;

Ne mbledhim, verifikojmë, përpunojmë dhe ruajmë të dhënat tuaja personale në pajtim me legjislacionin në fuqi për të përmbushur detyrimet tona ligjore dhe sipas kërkesave rregullative të autoriteteve/agjencive me kompetenca publike në zbatim të aplikimit dhe respektimit të: 1) Ligjeve në fuqi; 2) Rregulloreve të Bankës Qendrore e Republikës së Kosovës BQK-së; 3) Rregulloreve të Njësia e Inteligjencës Financiare NJIF, dhe 4) Autoriteteve të tjera shtetërore.

Ne mbledhim, përpunojmë dhe ruajmë të dhënat tuaja personale brenda qëllimit legjitim për lidhjen, zbatimin, ekzekutimin e një raporti kontraktual, brenda fushë veprimtarisë mikrofinanciare. Veprimet që Ne ndërmarrim me pëlqimin e dhënë nga Ju, na shërbejnë për të forcuar sigurinë e transaksioneve të realizuara dhe dëshmimin e të njëjtave, kurdo që na kërkohet nga autoritetet kompetente sipas ligjit.

Qasjen pro klientit dhe identifikimin e nevojave të tyre për produkte kreditore të qëlluara dhe me interes legjitim, komunikimin me klientin me qëllim të lidhjes, ekzekutimit dhe përfundimit të raportit kontraktual.

Ne i ruajmë të dhënat personale që kemi marrur/pranuar nga Ju, brenda periudhës kohore nga fillimi afatit të ruajtjes e deri në skadimin e këtij afati, e që pastaj inicohet procesi i asgjësimit sipas ligjit, akteve nën ligjore dhe politikave të brendshme të organizatës.

Ne kemi politikat që përcaktojnë veprimet dhe masat për sigurinë e të dhënave personale, dhe ju sigurojmë se kemi ndërmarrur të gjitha masat e sigurisë, veprimet organizative, pajisjet teknike-teknologjike për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e dokumentacionit dhe informatave me të dhëna personale. Pra, Ne garantojmë siguri për ruajtjen e të dhënave tuaja.

4. Me kë Ne i ndajmë të dhënat personale

Veprimtaria mikrofinanciare është e rregulluar me ligj dhe rregullore të BQK-së, andaj, Ne obligohemi që aktivitetin e tonë ta ushtrojnë në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullative, bazuar në këtë, të dhënat personale të mbledhura nga Ju, Ne i raportojmë apo i ndajmë me autoritetet relevante, siç janë Regjistrin Kreditor të Kosovës, Regjistrin e Pengut, Agjencia Kadastrale e Kosovës, autoritetet e drejtësisë, zyrat e noterëve, dhe autoritetet tjera publike relevante për inspektim nga fusha e mbrojtjes së konsumatorit, nga fusha e rregullimit të punësimit, etj, kur sipas ligjit Ne obligohemi që të dhënat e juaja ti raportojmë/ndajmë.

Ne, gjatë ushtrimit të veprimtarisë tonë, në raste specifike, të dhënat tuaja i ndajmë me bashkëpunëtorët tonë, si: zyrat e avokatisë, ekspertet financiar, zyrat e auditimit apo ofruesit e shërbimeve që japin shërbime të kontraktuara për dhe në emrin tonë, sipas kërkesave rregullative dhe sipas kontratës së shkruar. Gjatë bashkëpunimit me bashkëpunëtorët dhe partneret tonë, aplikojmë masa për mbrojtjen e informatave me të dhënave personale, duke zbatuar masa/klauzola kontraktuale strikte për ruajtjen e konfidencialitetit.

TË DREJTAT E JUAJA DHE SI MUND TI REALIZONI

1. Kufizimi i mbledhjes së të dhënave tuaja personale

Ju keni të drejtë që të na drejtoheni me Kërkesë për kufizimin e përpunimit të të dhënave tuaja personale. Në raste të tilla, sipas ligjit dhe politikave tona të brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale, Ne obligohemi ta kufizojmë mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave tuaja personale sipas kërkesës tuaj, Por, të dhënat tuaja që kemi mbledhur dhe përpunuar me pëlqimin tuaj personal përpara parashtimit të kërkesës për kufizim, Ne i ruajmë të mbyllura, për periudhë të caktuar sipas qëllimit të mbledhjes, për të përmbushur kërkesat ndaj autoriteteve publike dhe me arsye të justifikuara.

2. Kërkesa për ndërprerje të mbledhjes dhe përpunimit të dhënave personale

Ju keni të drejtë që të na drejtoheni me kërkesë për ndërprerje të përpunimit të dhënave tuaja personale. Në raste të tilla sipas ligjit dhe politikave tona të brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale, Ne obligohemi ta ndërpresim mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave tuaja personale sipas kërkesës tuaj. Por, të dhënat tuaja që kemi mbledhur dhe përpunuar me pëlqimin tuaj personal përpara parashtrimit të kërkesës për ndërprerje, Ne i ruajmë të mbyllura, për periudhë të caktuar sipas qëllimit të mbledhjes, për të përmbushur kërkesat ndaj autoriteteve publike dhe me arsye të justifikuara.

3. Ndryshimi/korrigjimi i të dhënave personale

Kurdo që vëreni gabime apo keni bërë ndryshime të dhënave tuaja personale, Ju keni të drejtë të na paraqitni kërkesë për përmirësim/plotësim apo ndryshim të dhënave tuaja personale që Ne i mbajmë, përpunojmë dhe i ruajmë. Bashkangjitur me kërkesën tuaj Ju jeni të obliguar që të bashkëngjisni dokumentacion valid i lëshuar nga organet publike kompetente, si dëshmi për korrigjim/plotësim apo ndryshim me të dhëna personale të sakta.

4. Kërkesa për fshirjen e të dhënave personale

Ju keni të drejtë të kërkonit fshirjen e të dhënave tuaja personale që Ne i ruajmë dhe apo përpunojmë, brenda kufizimeve ligjore. Por, të dhënat tuaja personale që Ne kemi mbledhur dhe përpunuar me pëlqimin tuaj personal përpara parashtrimit të kërkesës për fshirje, Ne i ruajmë të mbyllura, për periudhë të caktuar sipas qëllimit të mbledhjes, për të përmbushur kërkesat që i kemi ndaj autoriteteve publike dhe me arsye të justifikuara.

5. E drejta e qasjes

Ju keni të drejtë të keni qasje në të dhënat tuaja personale, respektivisht të kërkonit kopje të këtyre të dhënave që Ne kemi mbledhur, përpunuar dhe i ruajmë. Ju këtë të drejtë mund ta realizoni brenda periudhës kohore nga fillimi afatit të ruajtjes e deri në skadimin e këtij afati.

6. Kontaktimi i juaj me Ne / Parashtrimi i kërkesës

Lidhur me informacionet e lartshënuara dhe parashtrimin e ndonjë kërkesë/pyetje lidhur me të njëjtat, Ju mund të na kontaktoni, parashtroni kërkesa në e-mail adresën tonë mbrojtjaetedhenave@afkonline.org, në numrin e telefonit pa pagesë 0800-24-444, apo, mund të na vizitoni direkt në Zyrën Qendrore me adresë në Rr. Lidhja e Prizrenit Nr. 1 në Pejë, dhe në të gjitha degët tona në Kosovë, ku nëpunësit tonë do tu udhëzojnë dhe asistojnë që ta keni më të lehtë këtë proces.

Përfundim

Ne do ta bëjë përditësimin e këtij njoftimi sa here që të shfaqen ndryshime ligjore/rregullative dhe apo afariste, për çka juve ju ftojmë që, në raste kur shprehni interesim për shërbimet dhe produktet tona, përmes klikimit në platformën tonë *online*, të shkarkoni/merrni versionin e fundit të përditësuar të këtyre informacioneve.